<sup>2</sup> Autorizoj Autoritetin Kontraktor të bëjë verifikimet përkatëse të gjendjes gjyqësore të personave të deklaruar në këtë Deklaratë.

- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

**Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.**

**Data e dorëzimit të deklaratës \_\_\_\_\_**

**Nënshkrimi i ofertuesit \_\_\_\_\_**

**Vula \_\_\_\_\_**

**Shtojca 8/1**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik ]

**DEKLARATË MBI GARANTIMIN E ZBATUESHMËRISË SË DISPOZITAVE  
LIGJORE NË MARRËDHËNIET E PUNËS**

Deklaratë e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ me cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_, **deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:**

- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

**Data e dorëzimit të deklaratës** \_\_\_\_\_

**Përfaqësuesi i ofertuesit**

**Nënshkrimi**

**Vula**

## Shtojca 9

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor ]

### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr. 8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

**Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.**

**Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.**

**Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.**

**Veç kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:**

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

## 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1 ose Shtojcës 2 (në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburante, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje);
- b. Deklarate për paraqitje oferte të pavaruar sipas Shtojcës 2/1;
- c. Sigurimin e ofertës, (nëse është e zbatueshme) sipas Shtojcës 4;
- ç. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 6;
- d. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;
- dh. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 8/1;
- e. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

### 2.1. Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

*Sipas pikës 1 të kësaj shtojce.*

### 2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- 2.2.1 *Ne përmbushje të kapacitetit ekonomik dhe financiar, operatori ekonomik ofertues duhet të ketë realizuar xhiro mesatare vjetore, gjatë tre viteve të fundit financiare, në një vlerë të pakten prej 4,000,000 (katër milion) lekë.*

*Operatorët ekonomik që kanë aktivitet me pak se 3 (tre) vite, duhet të kenë xhiro mesatare, në vlerën e kerkuar të pakten prej 4,000,000 (katër milion) lekë.*

Si prove për plotësimin e këtij kriteri kualifikues, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë vërtetim nga Administrata Tatimore ku të tregohet xhiroja vjetore për vitet e sipërpermendura ose kopje të certifikuara të bilanceve.

### 2.3 Kapaciteti teknik:

- 2.3.1 *Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit, kontrata të ngjashme në një vlerë të pakten prej 4,000,000 (katër milion) lekë.*

*Lidhur me këto pike:*

*Kur OE ka realizuar kontrata me një ent publik, kerkohen vërtetime të lëshuara nga ky i fundit ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe furnizimet e realizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe furnizimet e realizuara. Faturat duhet të jenë të nenshkruara nga Shitesi dhe Bleresi.*

- 2.3.2 *Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin e prodhuesit / distributorit të autorizuar për të gjithë mallrat objekt prokurimi. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.*
- 2.3.3 *Operatori ekonomik ofertues që do të realizojë këto kontrata, duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikaten e menaxhimit të cilësive ISO 9001: të vlefshme, të leshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë dhe që të ketë lidhje me objektin e kontratës.*
- 2.3.4 *Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogun e prodhuesit për të gjithë mallrat objekt prokurimi, pjesë që i perkasin të dhënave teknike, të jetë e perkthyer në gjuhën shqipe dhe e noterizuar.*
- 2.3.5 **Tabela e Artikujve/mallrave të kerkuar**, paraqitur nga Autoriteti Kontraktor në Shtojcën 10 (specifikimet teknike) në DT, duhet të plotësohen rigorozisht nga Ofertuesi, për të gjithë artikujt e tabelës që kerkohen. Të kjo tabelë nga ofertuesi duhet të plotësohet: Emri i kompanisë prodhuese, Emertimi i katalogut të artikullit/produktit, Nr. i faqes së këtij katalogu si dhe Nr. referencës ose Kodi i artikullit nxjerrë nga manuali i prodhuesit për të gjithë ato artikuj që kerkohen në këto tabelë.

**Mosplotesimi korrekt i tabelës, është element skualifikues.**

- 2.3.6 *Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë ku të cilësojë se mallrat e ofruara prej Tij, janë të reja dhe jo të rikonstruara.*
- 2.3.7 *Në funksion të plotësimit të Shtojcës 8 “Deklaratë mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme” Operatori Ekonomik ofertues duhet të japë të dhëna të qarta si Emer, Mbiemer, Ates, Amesi, Datelindje, Vendlindje, Numer Personal, si dhe kopje të skanuar të dokumentit të identifikimit (shqiptar ose të huaj), për Administratorin/Administratoret e shoqërisë, Ortakun/Ortakët e shoqërisë, përfaqësues të ndryshëm të posacem të shoqërisë, drejtues të ndryshëm të shoqërisë.*

**Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.**

**Shënim: Në respektim të nenit 23 të LPP-se në të gjitha rastet kur përmendet “marke” përfshihet termi “ekuivalente”.**



## Shtojca 10

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor ]

### SPECIFIKIMET TEKNIKE

#### Blerje vegla pune për mirëmbajtjen e rrjetit OPGW

#### PERSHKRIM I PERGJITHSHEM

Mirëmbajtja e rrjetit të telekomunikacionit konsiderohet garantimi i shërbimeve teknike të OST-së për rrjet dhe operim të qëndrueshem të gjithë sistememeve. Strategjia e shërbimit të telekomunikacionit për OST synon ofrimin e një përgjigje të shpejtë dhe efektive në rast të keqfunksionimit të rrjetit pasiv OPGW , si dhe në garantimin e zgjidhjeve profesionale O&M në mënyre të qëndrueshme

Në programin e zhvillimit ekonomik të OST për vitin 2020 është parashikuar blerja e gjashte seteve vegla pune ne funksion te mirmbajtjes se rrjetit OPGW nga NJO –te me objekt:“Vegla pune per mirembajtjen e rrjetit OPGW ”

#### PORTOFOLI I KERKEKUAR :

- Splicer përbashkimin e fibrave optike (6 Sete)
- KompletVeglapuneStandard Fiber Optike (6 Sete)
- OTDR modular per tesimin eparametravetëFibrave Optike (6 copë)
- OTDR Launch Cable, Single Mode, 1000m SC-SC or FC/PC (6 copë)
- Trajnimnë distance dhe Certifikim per modulet, Splicer & OTDR për (6 punonjes)

#### PERSHKRIMI I SPECIFIKIMEVE

##### 1. FUSION SPLICER

Splicer është pajisje që shërben për ngjitjen e fibrave optike me hark elektrikdheajo duhet të plotësojë kërkesat si me mëposhte:

- Splicer (Bashkus Fibre) duhet të ketë aftësinë për të kryer ngjitjen (core to core) ne menyre te sakte dhe automatike, pavarësisht përqendrimit të veshjes se FO-se.
- Splicer (Bashkus Fibre) duhet të mundesoje bashkimin e fibrave të llojeve të mëposhtme: SM (ITU-T G.652&G.657) / MM (ITU-T G.651) / DS (ITU-T G.653) / NZDS (ITU-T G.655)
- Splicer (Bashkus Fibre) duhet të identifikojë automatikisht llojin e fibrave qe eshte duke u perdorur si dhe te rregulloje ne menyre automatike parametrat per nje hark elektrik bashkimi.

- Splicer duhet të pranojë fibra me diametër veshje deri në 3000 µm duke përdorur aksesoren e duhur të qendrimit.
- Morsetat që fiksojnë fibra duhet të kenë aftësinë të përshtaten menjëherë për aplikime të ndryshme dhe të mbajë në mënyrë të lirë fibren
- Splicer duhet të ketë aftësinë për të bashkuar fijet me gjatësi 5-16 mm
- Pamja dhe shfaqja e fibrave duhet të jetë e mundur në dy boshte X, Y, XY, X/Y
- Splicer duhet të ketë aftësinë për të vlerësuar humbjen gjatë bashkimit.
- Humbja tipike e bashkimit duhet të jetë SM: 0.02dB / MM:0.01dB / DS:0.04dB / NZDS: 0.04dB / G.657: 0.02dB (ITU-T Standard)
- Koha tipike e bashkimit duhet të jetë 7s -9s per SM.
- Splicer (Bashkus Fibre) duhet të ketë minimumi 100 mënyra bashkimi dhe minimumi 30 mënyra ngrohjeje
- Kohët tipike të furrës për tubin vetëshkrires kërkohej të jete deri 13 Sek
- Splicer duhet të ketë aftësinë për të punuar me tubin vetëshkrires mbrojtës 20~60 mm në gjatësi
- Furnizimi me energji duhet të sigurohet përmes baterisë së rimbushur dhe përmes adaptorit AC
- Një bateri e plotë duhet të sigurojë minimumi 170 cikle bashkimi dhe ngrohjeje
- Jetëgjatësia e elektrodës duhet të jetë minimumi 5,000 bashkime
- Elektrodat duhet të jenë lehtësisht të zvendësueshme pa përdorur asnjë mjet ndihmes
- Splicer duhet të ketë mekanizma automatikë që zvogëlojnë numrin e veprimeve manuale në
- procesin e bashkimit dhe gjithashtu zvogëlojnë kohën totale të kërkuar
- Splicer duhet të ketë memorie të brendshme për minimumi 10,000 rezultate të bashkimit
- Splicer duhet të ketë një ekran 5 "me prekje ose me të madh.
- Splicer duhet të jete i përshtatshëm për të punuar sipas kushteve të terrenit: 0~5000m mbi nivelin e detit, 0~95% ngarkesa e lageshtise, të operojë në temperaturë -10~50°C, të operojë në kushte të fryrjes së erësderi 15m/s

### 1.1 (Optical fiber cleaver) prerësi i fibrave duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme:

- Këndi i prerjes të fibrave është zakonisht 0,7 gradë ose 0.5
- Koha e jetëgjatësisë së tehut të prerjes duhet të jetë 48,000fibra të prera ose më shumë
- Tehu duhet të jetë lehtësisht i ndryshueshem nga përdoruesinë terren
- Gjatësia e prerjes duhet të jetë 8-20 mm
- Ndryshimi i pozicionit të tehut duhet të jetë i thjeshtë
- Diametri maksimal i lejuar i veshjes duhet të jetë deri në 3000 µm
- Prerësi duhet të jete i aplikueshem për fiber teke : 250µm, 900µm, 3.0mm

### 1.2 Paketa Kit Splicer duhet të përmbajë:

*Bashkues fibre, adapter AC adaptor me kabell tensioni ,2 bateri , kabëll USB , elektrodë rezervë 2 cope , enë alkooli, zhveshës me 3 vrima (2-3 mm, 900 dhe 250µm), tabaka pune , 2 prerësa fibre, kuti e e përshtatur për të punuar në terrene të veshitura*

## 2. Set Veglash \_Fiber Optic Tools

Kiti i veglave te punes sherben për përgatitjen e kabllit para se te nisi joint .Ato duhet të përmbajë të gjitha mjetet e nevojshme për bashkimin , zhvrehjen , dhe përgatitjen e OPGW si me poshte :

- Valixhe e fortë për mbajtjen e mjeteve dhe veglave
- Zhveshës fibre e pershtetur për veshje me 3 vrime, 2-3 mm, 900 dhe 250um
- Prerës i tubave të lirshëm
- Zyze mbrojtese
- Prerës i tubave të levizeshem (tip kunj)
- Vegla prerese dhe zhveshese te kablllove te ndryshem
- Gërshërë prerese
- Gur fleksibel me bateri + ushqyes per ngarkim baterie e pershtateshme per prerje OPGW
- Pastrues I lengeshem të fibrave
- Peceta me garzë pastrami 1 pako (80 come)
- Sythat pambuku pa garzë
- Enë për asgjësimin e fibrave
- Leckë pastrimi e ripërdorshme
- Pastrues me një klikim për tragete / kryqëzime 2.5 mm
- Pastrues me një klikim për pirunat / mbushatat 1, 25 mm MU / LC
- Vegla te ndryshme, thika te ndryshme, kasetë, kaçavidat te ndryshme, pinca te ndryshme sharrë hekuri të vogël, komplet kaçavidash precise, celesa egzagon, meter etj

## 3. OTDR (Instrumenti testimit te fibrave optike

Aparati testues i Fibres Optike është nje mjet i domosdoshem per instalime dhe mirembajtje OPGW . Ai duhet te mbështetet ne standartet dhe teknologjitë e reja që kërkohen për të trajtuar aplikacione të ndryshme te rrjetit.

Karakteristikat kryesore:

Duhet te thjeshtoj testimin duke perfshire te gjitha modulet ne nje pajisje te vetme

Te jete i optimizuar për përdorim në terren me një ekran multitouch, raporte te shkruar dhe rezultate të qarta.Paisja OTDR duhet te jete modulare, që lejon rregullimin në një gamë të gjerë të aplikacioneve dhe te perfshije modulet me poshte :

- Burimi i padukshem i drites (1310/1550nm) CW, 1kHz, 2kHz modulated and 1kHz & 2kHz blink.
- OPM (Optical Power Meter) e cila perdoret per te matur fuqine optikale ne rrjetet e fibres optike qe operojne ne 850nm, 1300nm, 1310nm, 1490 nm, 1550 nm, 1610 nm, 1625 nm
- VLF (Visual Fault Locator) identifikon vizualisht defektet ose identifikon duke leshuar nje drite te forte te kuqe lazeri(e cila mund te arrije ne largesine prej 10km)

- Instrumenti duhet të ketë diapazon të lartë dinamik prej minimum 39dB për të gjitha gjatësitë e valës testuese .

### 3.1 Karakteristikat teknike:

Instrumenti duhet të ketë OTDR të integruar të karakteristikave të mëposhtme:

- Llojin e ngjarjes
- distanca mes ngjarjeve
- humbja e secilës ngjarje
- pasqyrimi i secilës ngjarje
- pjerrësia e fibrave
- humbja totale e lidhjes
- Humbja Optike dhe Kthimit

#### Tabela përmbledhese e ngjarjeve

Shfaqja njëkohësisht e historikut reference në ekran në mënyrë që të krahasohet gjurma e matur me gjurmët e regjistruara me pare

- Ndërfaqja optike duhet te kete konektor universal APC, (FC/SC/LC)
- Matjet e OTDR me lazer të klasës 1 në gjatësitë e valës:

- 1310 ± 20 nm me dinamik ± 40dB
- 1550 20 nm me dinamik ± 40dB
- filtruar 1650 ± 20 nm me dinamike ± 40dB

- Zona e Vdekur e ngjarjes duhet të jetë 0.9 -1 m ose më pak
- Zbutja Zona e Vdekur duhet të jetë ± 4 m ose më pak
- Numri i të dhënave jo më pak se 256,000
- Instrumenti duhet të ketë ndërfaqe të ndryshme komunikimi, të paktën 2 port USB për t'u lidhur me pajisjet e jashtme, si dhe ndërfaqe të integruara WiFi
- Instrumenti duhet te jete i paisur me karikues AC Input 100-240V, 50-60Hz / DC Input 19V, 3.42A

#### Ekрани:

- Ekran me prekje me rezolucion të lartë, me ngjyra, me shikueshmëri të mirë në të gjitha kushtet
- Madhësia e ekranit prefrohet te jete 7 inches & Ndricim i larte TFT LCD,
- Instrumenti duhet të ketë memorie të brendshme 8GB për të ruajtur matjet ne OTDR me aftësinë për tu zgjeruar duke përdorur memorie Flash USB
- Mundësia për të kontrolluar në distancë një instrument përmes USB dhe WiFi, si dhe për të transferuar të dhëna
- Instrumenti duhet të ketë bateri dhe furnizim me energji AC, dhe autonomia e baterisë së rimbushshme duhet të jetë 10-12 Ore. Bateria duhet të jetë lehtësisht e nderrueshme nga përdoruesi.

- Instrumenti duhet të ketë aftësinë për të gjeneruar dhe lexuar raporte në formatin SOR, JPG, PDF
- Instrumenti duhet të ketë një mënyrë të thjeshtë funksionimi që mundëson fillimin e matjeve me minimumin e hapave të cilësimeve, si dhe mënyrën e ekspertëve që mundëson matjet me cilësime manuale të përparura të parametrave të shumtë
- Instrumenti duhet të ketë aftësinë për të thjeshtuar pamjen e lidhjes OTDR dhe ngjarjeve të zbuluara duke përdorur ikona (interpretimi i bazuar në ikona i ngjarjeve të zbuluara nga skedarët .sor), i cili jep një interpretim të qartë dhe të thjeshtë të rezultateve.
- Instrumenti duhet të ketë aftësinë për të ruajtur automatikisht rezultatet
- Instrumenti duhet të përfshijë zgjedhjen e pragjeve të alarmit, për ngjarjet optike sipas standardeve të industrisë, si dhe aftësinë për të vendosur vlerat e përcaktuara nga përdoruesi
- Të gjitha hyrjet dhe daljet e instrumentit duhet të mbrohen nga pluhuri

***Instrumenti duhet të dorëzohet me aksesoret e mëposhtëm:***

- Përshtatës / ngarkues i rrymës AC
- Bateri
- Kablo USB
- Kutia e transportit
- Manual përdorimi
- Tre tipevecantaKonektorelidhes per Fiber optike te tipit APC (FC, SC, LC)

**OTDR Launch Cable, Single Mode, 1000m FC/PC**

**PERSHKRIMI I SPECIFIKIMEVE**

Kutia Launch OTDR ka shumë emeritime te tjera sipas funksionit dhe parimit të punës, qe mundet te quhen psh . kutia e zonës së vdekur, shtypësi i pulsit, unaza e fibrave, ose zgjatues i fibrave optike. Ky zgjatues sherben per te minimizuar evektin e zonës së vdekur gjate testimit me OTDR . Zona e vdekur e OTDR shkaktohet nga niveli i lartë i reflektimit të kthimit dhe i prekur nga gjerësia e pulsit, ajo mund të shtrihet njëqind metra larg nga OTDR.Zgjatuesi optike rekomandohet të përdoret përpara se të testohet fibra optike . Ky zgjatues duhet te jete i futur ne nje box ne menyre qe te jete i mbrojtur nga goditjet . Gjatesia e fibres ne BOX kerkohet te jete 1000 m dhe konektoret ne skajet e veta do te jene te tipit SC/SC ose FC/PC

Shembull me poshte ne figure:



## Specifikimet teknike

Tipi i fibres	9/125 Single mode	Length	1km
Connector 1	FC/UPC	Connector 2	FC/UPC
Material	SR Polypropylene	Typical Loss	< 0.5dB@1310nm for 1000 meters
Temperatura operimit	e -40~ +55°C	Dimensions	n/a

### 5. Dy ditë Trajnimi dhe Certifikimi për gjashtë punonjes.

Trajnimi dhe certifikimi i punonjesve është një kerkese e rëndësishme e cila kositon në përgatitjen e stafit për të qene përdorues dhe njohës të mjeteve dhe veglave të punës, objekt i këtij procesi prokurimi. Trajnimi teorik dhe certifikimi do të kryhet online nga instruktoret e furnizuesit të paisjeve duke konsideruar pikat e mëposhtme:

#### i. Dita e parë

Trajnimi për modulën OTDR do të kryhet online dhe përfshin, mënyrën e funksionimit të OTDR-ve, metodat dhe aplikacione të ndryshme të testimit optik me pas një përmbledhje të shkurtër të CPRJ-se. Certifikimi bazohet në ushtrime praktike dhe kalimin e një provimi të shkurtër me shkrim.

- Hyrje në fibra optike
- Kabllot dhe Llojet e konektoreve
- Matjet, si funksionon një OTDR
- Specifikimet, parametrat, konfigurimi
- Metodat e Testimit Optik OTDR, PM, LS, YFL
- Testi i kthimit mbrapa
- Shikimi dhe leximi i raporteve
- Kopjimi i materjaleve dhe transferimi i tyre në USB
- Llogaritja e zbutjes dhe zonave të vdekura të ngjarjeve
- Shkaqet e reflektimit në fibra
- Metoda e matjes së OTDR bazuar në diapazonin dinamik
- Matjet manuale të OTDR duke përdorur shenjues:
- Humbja e ngjarjes me kater pike
- Reflektimi prej tre pikësh
- ORL me dy pika
- Zbutja e seksionit të parafrimit të katrorit me të pakte (LSA)
- Cilesimet e parametrave për karakterizimin e lidhjeve me fibra:
- Diapazoni i distancës, Gjerësia e pulsit, Koha mesatare

- Gjatesia e vales, Indeksi i thyerjes (IOR)
- Permbledhje e vecorive te OLM

## ii. Dita e dyte

Trajnimi teorik dhe praktik shoqeruar me video online per paisjet Fusion splicer:

- Metoden e pregatitjes OPGW gati per ngjitje me shkrirje
- Metoda e zhveshjes se fibrave
- Kendi i prerjes FO
- Instalimi i tyre ne kasete, futja e tyre ne join box, metoda e matjes se ngjitjes bazuar ne teorine e pergjithshme.
- Instalimi i kabllave nentokesore dhe ajror metodat e perdorimit.
- Testimi i bashkimit te fibres me shkrirje, perfundimi dhe pergatitja e raportit.
- Pergatitja e kabllave ADSS, ADKASH dhe OPGW, testimi i mirembajtjes rutine,

Para certifikimit punonjesit do te demonstrojne ngjitje e nje kablli optik dhe do te beje testimin gjithepershires ne forme raporti.

Ne kete trajnim do te marrin pjese gjashte punonjes.

### Tabela e Artikujve/mallrave te kerkuar

Te dhena te plotesuar nga AK			Te dhenat qe duhen plotësuar nga Ofertuesi		
1	2	3	5	6	7
Nr	Përshkrimi i mallrave	Njesia	Emri i kompanise prodhuese	Emertimi i katalogut te artikullit/ produktit	Nr. i faqes se ketij katalogu si dhe Nr references ose Kodi i artikullit nxjerre nga manuali i prodhuesit
1	Splicer për bashkimin e fibrave optike	set			
2	Komplet Vegla pune Standard Fiber Optike	set			
3	OTDR modular per tesimin e parametrave të Fibrave Optike	cope			
4	OTDR Launch Cable, Single Mode, 1000m SC-SC or FC/PC	copë			

**Shënim:** Ne respektim te nenit 23 te LPP-se ne te gjitha rastet kur permendet “marke” perfsihet termi “ekuivalente”.

**Shtojca 11**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në Marrëveshjen Kuadër]

**PLANIFIKIMI I  
KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

<input type="checkbox"/> Mall: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër _____		
<b>Kontrata Nr.</b>	<b>Titulli i Kontratës</b>	<b>Përshkrim i shkurtër i kontratës</b>
<b>01</b>	_____	_____
<b>02</b>	_____	_____
<b>03</b>	_____	_____
<b>...</b>	_____	_____



**Shtojca 12**

( Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

**SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT**

<b>1</b>	<b>2</b>		<b>3</b>
<b>Nr.</b>	<b>Përshkrimi i mallrave</b>	<b>Njesia</b>	<b>Sasia</b>
1	Splicer përbashkimin e fibrave optike	Set	6
2	Komplet Vegla pune Standard Fiber Optike	Set	6
3	OTDR modular per tesimin e parametrave të Fibrave Optike	Cope	6
4	OTDR Launch Cable, Single Mode, 1000m SC-SC or FC/PC	Cope	6
5	Trajnim në distance dhe Certifikim per modulet, Splicer & OTDR për punonjes	Komplet	6

**Afatet e lëvrimet: 5 (pesë) muaj nga hyrja ne fuqi e kontratës.**

**Shtojca 13**

[ Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

**NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR<sup>3</sup>**

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s’kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

---

---

---

---

---

---

---

---

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt

< **Emri** >

---

<sup>3</sup> Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore

## Shtojca 14

[ Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

### FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

\* \* \*

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët  oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [\_\_\_\_\_] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

\* \* \*

[ Titullari i autoritetit kontraktor]

## Shtojca 15

[ Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

### FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_

\* \* \*

Procedura e prokurimit: \_\_\_\_\_

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia, objekti, kohëzgjatja e kontratës etj]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:  oferta ekonomikisht më e favorshme  çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatorën e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. \_\_\_\_\_

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

2. \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Perkatësisht për arsyt e mëposhtme:

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_/Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

2. \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_/Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

Etj.\_\_\_\_

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

[Titullari i autoritetit kontraktor]

## Shtojca 16

### KUSHTET E PËRGJITHSHME Mallrat – Tender i Hapur

#### Neni 1: Qellimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për blerjen e Mallrave të prokuruarra me anë të procedurës me negociim.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

#### Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga Dokumentat e Tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha shtojcat dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “çmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontratore.
- 2.3 “Incoterms” do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë detyrimet përkatëse, kostot, dhe risqet e lidhura me transferimin e Mallrave nga shitësi tek blerësi.
- 2.4 “Lëvrimi” do të thotë të gjitha aktivitetet dhe veprimet që mundësojnë marrjen e Mallrave në vendin e shpërndarjes siç specifikohet në kontratë si paketimi, transportimi, sigurimi, tarifat, procedura doganore, ngarkimi dhe shkarkimi, instalimi, mbledhja, bashkimi, kontrollimi i veprimeve dhe mbikëqyrja e gjithë kësaj veprimtarie.

- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen Mallrat. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate furnizon Mallrat.
- 2.7 “Palë (t)” do të thotë nënshkruarit e kontratës.
- 2.8 “Mallrat” do të thotë materialet e papërpunuara, produktet, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurtë, të lëngshme ose të gaztë.
- 2.9 “Shërbimet e lidhura me to” do të thotë shërbimet ndihmëse ose të paparashikuara të furnizimit të Mallrave, si transportimi, instalimi, mirëmbajtja, trajnimi, shërbimet mbështetëse ose detyrime të ngjashme në lidhje me furnizimin e Mallrave.
- 2.10 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Mallrat dhe Shërbimet e lidhura me to që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.11 “Standarde Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një organ i posaçëm standardizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarde të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

### **Neni 3: Hartimi i Kontratës**

- 3.1 Njoftimi i ofertës fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të parashikuar në Dokumentat e Tenderit.
- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

### **Neni 4: Praktikat e Korrupsionit, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve**

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ndonjë ent tjetër që ka marrë pjesë në përgatitjen e Dokumentave të Tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

### **Neni 5: Informacioni Konfidencial**



- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktuesi mund t’i japë nënkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar për nënkontraktuesin të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nën-Kontraktuesin një dispozitë që parashikon ruajtjen e konfidencialitetit siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

#### **Neni 6: Pronësia Intelektuale**

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës do t’i përkasin Autoritetin Kontraktor i cili mund t’i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Kontraktuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t’i parashtojë Autoriteti Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramet, skicimet, specifikimet, planet, statistikën, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t’i përdorë për qëllime që s’kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 6.3 Kontraktuesi duhet të shkarkojë Autoritetin Kontraktor nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronësisë intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose shpërndarja e Mallrave sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronësisë intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i Mallrave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t’i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

#### **Neni 7: Origjina e Mallrave**

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së mallrave, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktuesi mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e mallrave.
- 7.3 Për qëllime verifikimi, “origjinë” do të thotë vendi ku mallrat janë nxjerrë, ose prodhuar. Mallrat janë prodhuar kur, nëpërmjet përpunimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e mallrave ka dallim nga kombësia e Kontraktuesit ose nënkontraktuesit që siguron mallrat.

### **Neni 8: Qëllimi i Furnizimit dhe Përshtatshmëria e Mallrave me Specifikimet**

- 8.1 Kontraktuesi duhet të dorëzojë Mallrat në përputhje me cilësinë, sasinë dhe llojin e specifikuar në kontratë, si dhe të vendosura dhe paketuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.
- 8.2 Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën, nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin e posaçëm të parashikuar në kontratë. Kur nuk është e mundur të përcaktohet një gjë e tillë, thuhet se Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin për të cilin sherbejne zakonisht sendet e tjera të të njëjtit lloj.
- 8.3 Nëse shitja është bërë në bazë të një modeli ose kampioni, shitësi (Kontraktuesi) duhet të dorëzojë sendet që kanë të njëjtat cilësi si të modelit ose kampionit.

### **Neni 9: Përputhshmëria e Mallrave me Standardet Teknike**

- 9.1 Mallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jenë konform kodeve dhe Standardeve Teknike të parashikuara në specifikimet teknike. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në kodet përkatëse ose në Standardet Teknike, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pas aprovimit nga Autoriteti Kontraktor.
- 9.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet nga ndonjë dispozite tjetër e kontratës, kur nuk është përcaktuar asnjë Standard Teknik përkatës në specifikimet teknike, Mallrat duhet të jenë konform Standardeve Teknike ndërkombëtare. Nëse nuk ekzistojnë Standarde Teknike ndërkombëtare, Mallrat duhet të jenë konform Standardeve Teknike përkatëse Shqiptare.
- 9.3 Kontraktuesi nuk mban përgjegjësi për gabime në skicim, të dhëna, vizatim ose çdo aspekt tjetër të specifikimeve teknike të dhëna nga Autoriteti Kontraktor me përjashtim të rastit kur gabimi ishte aq i dukshëm sa Kontraktuesi duhet ta kishte parë dhe këshilluar Autoritetin Kontraktor për të.
- 9.4 Shitësi (Kontraktuesi) nuk mban përgjegjësi për defekte të Mallrave për të cilat Autoriteti Kontraktor ishte në dijeni në momentin e lidhjes së kontratës ose nuk ishte në dijeni për faj të tij, me përjashtim të rastit kur defektet kanë të bëjnë me cilësinë e Mallrave të specifikuar sipas kontratës ose përfaqësimin e reklamës së shitësit (Kontraktuesit).

### **Neni 10: Pjesët e Këmbimit**

- 10.1 Nëse është e parashikuar në kontratë, Kontraktuesi duhet të përfshijë me Mallrat e lëvruara një sasi pjesësh këmbimi, në përputhje me specifikimet teknike dhe çdo dispozitë përkatëse të kontratës.
- 10.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe, pjesët e këmbimit do të dorëzohen bashkë me Mallrat.
- 10.3 Kontraktuesi duhet të garantojë disponueshmërinë e pjesëve të këmbimit për një periudhë të specifikuar në ofertën e tij dhe të barabartë me jetëgjatësinë e përdorimit të Mallrave.

- 10.4 Në rast të një vendimi të ndërprerjes së prodhimit të pjesëve të këmbimit, Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktor brenda një kohe të arsyeshme/mjaftueshme për t’i lënë mundësi atij që të prokurojë sasi të mjaftueshme për përdorim të mëvonshëm.
